



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:144102

Datë: 21.08.2024

Numri i dokumentit: 06070669

C.nr. 4981/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Ermir Ahmetaj, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit Xh.S me numër identifikues, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson V.B, avokat nga, kundër të paditurës Posta e Kosovës SH.A., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Sh.M, avokat nga, me objekt kontesti: anulim vendimi dhe kompensim i pagave, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 05.07.2024 në prezencën e përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, me datë 21.08.2024, mori këtë:

AKTGJYKIM

- I. REFUZOHET NË TËRËSI SI E PABAZUAR kërkesëpadia e paditësit Xh.S me të cilën ka kërkuar që të I. Të aprovet në tërësi kërkesëpadia e paditësit; II. Të anulohet si i paligjshëm vendimi i bordit të përkohshëm të drejtorëve me nr. 19-21 i datës 03.06.2021 i protokolluar në arkivin e Postës së Kosovës me datë 08.06.2021; III. Të obligohet e paditura Posta e Kosovës që të kompensojë paditësin në shumën totale prej 53,340.91 euro dhe atë në emër të pagës neto shumën prej 46,339.07 euro, në emër të kontributit pensional të të punësuarit shumën prej 2,667.05 euro, në emër të kontributit pensional në emër të punëdhënësit shumën prej 2,667.05 euro, në emër të tatimit në paga në dobi të Buxhetit të Kosovës shumën prej 4,334.79 euro, të gjitha këto me kamatëvonesë prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë e deri në ekzekutimin final.
- II. DETYROHET paditësi Xh.S që t'ia paguajë të paditurit shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1,409.60 euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

Arsyetim

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij me datë 05.07.2021 ka parashtruar padi ndaj të paditurit. Në padi, përgjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka theksuar se paditësi me vendim të Bordit të Drejtorëve të Postës së Kosovës nr. 8-21 të datës 05.03.2021 është zgjedhur Kryeshef Ekzekutiv. Tutje ka theksuar se Bordi me vendim ka përcaktuar që kohëzgjatja e marrëdhënies së punës së paditësit është 36 muaj ku paditësi ka nënshkruar kontratën me nr. 01-1042-21 nga data 16.04.2021 deri me datë 04.03.2024. Më tej ka theksuar se Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve në vendimin e tij nr. 19-21 të datës 03.06.2021 nr. protokollit 01-1403/21 të datës 08.06.2021 në Postën e Kosovës ka shkelur thelbësisht dhe pakontestueshëm edhe formën dhe përmbajtjen e vendimit kur vendosë për të drejtat themelore nga marrëdhënia e punës e paditësit pasi që vendimi nuk përmban kurrfarë arsytimi, përveç një fraze se arsytimi ndodhet në procesverbalin e mbledhjes së Bordit të Drejtorëve të datës 03.06.2021, dhe në aspektin procedural ky vendim

i NPQ është tërësisht në mungesë të arsytimit si pjesë themelore e një vendimi. Ka theksuar gjithashtu se vendimit të Bordit të Drejtorëve i mungon edhe këshilla juridike si element thelbësor kur vendoset për të drejtat e paditësit. Po ashtu ka shtuar se në kuptim të nenit 52 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative përcaktohen taksativisht kushtet të cilat e bëjnë një akt të paligjshëm dhe atë: 1.3 është rezultat i shkeljes së dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.4. është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material.

Përfaqësuesi i paditësit, përgjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare, më tej ka deklaruar se është vërtetuar se vendimi i të paditurës ka qenë arbitrar dhe i mbështetur vetëm në nenin 21 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike. Po ashtu ka deklaruar se ndërprerja e kontratës së punës është bërë në kundërshtim të plotë me nenin 70 dhe 71 të Ligjit të Punës pa asnjë paralajmërim me shkrim së paku 60 ditë më herët duke qenë se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune me të paditurën mbi 10 vite. Në seancën e datës 05.07.2024, pas pranimit të ekspertizës financiare, përfaqësuesi i paditësit ka precizuar kërkesëpadinë duke kërkuar nga Gjykata që: I. Të aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit; II. Të anulohet si i paligjshëm vendimi i bordit të përkohshëm të drejtorëve me nr. 19-21 i datës 03.06.2021 i protokolluar në arkivin e Postës së Kosovës me datë 08.06.2021; II. Të obligohet e paditura Posta e Kosovës që të kompensojë paditësin në shumën totale prej 53,340.91 euro dhe atë në emër të pagës neto shumën prej 46,339.07 euro, në emër të kontributit pensional të të punësuarit shumën prej 2,667.05 euro, në emër të kontributit pensional në emër të punëdhënësit shumën prej 2,667.05 euro, në emër të tatimit në paga në dobi të Buxhetit të Kosovës shumën prej 4,334.79 euro, të gjitha këto me kamatëvonesë prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë e deri në ekzekutimin final.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe i ka specifikuar.

I autorizuari i të paditurës në përgjigjen në padi, në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se e kundërshton në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Më tej ka theksuar se baza ligjore për ndërprerjen e marrëdhënies së punës është e përcaktuar në nenin 21 par. 1 të Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike. Ka deklaruar më tej se vendimi i Bordit të PK-së për ndërprerjen e kontratës së punës së paditësit ka qenë i drejtë dhe në përputhje me dispozitat ligjore ngase me rastin e përzgjedhjes së tij në pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv është shkelur kriteri i pavarësisë nga neni 13 i Ligjit nr. 04/L-111 për ndryshim plotësimin e ligjit bazik për ndërmarrjet publike nr. 03/L-087, me të cilin riformulohet neni 21 par. 4 i ligjit bazik në ndërlidhje me nenin 17 par. 2 pika k), ngase paditësi ka qenë kandidat politik për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës në vitin 2019 në periudhën prej 36 muaj, para datës së aplikimit për pozitën në fjalë. Tutje ka deklaruar se në nenin 49 të LPPA-së përcaktohen rastet kur akti administrativ mund të jetë edhe pa arsytim, dhe sipas nën par. 1.1 të par. 1 të nenit 49 të LPPA njëri ndër rastet kur nuk është i nevojshëm që akti administrativ të përmbajë arsytim është kur në gjë e tillë përjashtohet shprehimisht me ligj dhe një përjashtim i tillë është parashikuar me nenin 21 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike. Mbi bazën e këtyre pretendimeve i ka propozuar Gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë në tërësi si të pabazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe i ka specifikuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, lidhur me çështjen konkrete juridike, në shqyrtimin kryesor-publik, gjykata bëri administrimin e provave si: Konkursi publik për vend të punës i publikuar me datë 16.01.2021; Draft agjenda e bordit të përkohshëm të drejtorëve e datës 03.06.2021; Procesverbali nr. 09/2021 i datës 03.06.2021 i mbledhjes së bordit të përkohshëm i protokolluar me nr. 01-1590/2021 i datës 30.06.2021; Vendimi me nr. protokoll 01-1064/2021 date 19.04.2021; Vërtetimi me nr. protokoll 03-1478/2021 datë 16.06.2021; Kontrata e punës për kohë të caktuar me nr. pro.01-1042/2021 e datës 16.04.2021; Vendimi nr. 19-21 i datës 03.06.2021 i protokolluar me nr. 01-1403/2021 i datës 08.06.2021; Vendimi me nr. 08-21 i datës 05.03.2021 i protokolluar me nr 01-642/2021 i datës 05.03.2021; Ekspertiza financiare e datës 23.04.2024 dhe plotësimi i saj i datës 31.05.2024; Rregullorja për rregullimin e marrëdhënies së punës për zyrtarët e lartë të Postës së Kosovës me nr. protokoll 01-478/2021 i datës 18.02.2021; Rezultatet sipas kandidateve për Kosove për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2019; dhe Certifikata nga evidenca penale e datës 22.10.2018.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për arsyet e dhëna në këtë aktgjykim.

Nga provat shkresore të administruara, por edhe nga pohimet e palëve ndërgjyqëse, para gjykatës rezultuan të jenë disa fakte të pa kontestuara. Ndër to se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, i caktuar në detyrat e punës si Kryeshef Ekzekutiv përmes Vendimit 08-21 të datës 05.03.2021 dhe kontratës së punës me kohët të caktuar me nr. 01-1042/21 datë 16.04.2021. Po ashtu nuk rezultoi të jetë kontestues fakti se paditësit, përmes vendimit të datës 03.06.2021 me numër 19-21 i ndërpritet marrëdhënia e punës.

Çështje kryesore kontestuese mes palëve ndërgjyqëse mbetet, nëse shkëputja e marrëdhënies së punës paditësit ishte bërë në kundërshtim me dispozitat e ligjore, kurse për këtë në thelb palët kishin pikëpamje të ndryshme nga njëra tjetra.

Gjykata gjeti se paditësi ka qenë i punësuar tek e paditura me kontratë në kohë të caktuar nga data 05.03.2021 deri me datë 04.03.2024, me të ardhura mujore në lartësi bruto prej 1,750 €. Përmes administrimit të vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me numër 19-21 datë 03.06.2021 gjykata gjeti se ndërprerja e marrëdhënies së punës së paditësit ka ardhur si rezultat i diskutimeve të Bordit të përkohshëm të Drejtorëve të datës 03.06.2021 nr. 09/21. Në bazë të arsytimit të këtij vendimi, konstatohet se nxjerrjes së tij i ka paraprirë mbledhja e Bordit të drejtorëve të të paditurës të së njëjtës datë. Përmes procesverbalit të mbajtur nga mbledhja e Bordit të përkohshëm të drejtorëve konstatohet se ndër pikat e rendit të ditës ka qenë edhe shqyrtimi i pozitës së Kryshefit Ekzekutiv. Po ashtu nga ky procesverbal vërtetohet se është vënë në diskutim propozimi për shkarkimin e paditësit nga pozita që ka mbajtur. Në këtë procesverbal janë bërë diskutime dhe janë dhënë arsyet mbi shkarkimin e paditësit nga pozita e Kryshefit Ekzekutiv, ku ndër të tjera janë theksuar procedura jo e rregullt e përzgjedhjes, dyshimet mbi konflikt dhe si mesazhet kërcënuese të drejtuara sekretarit. Më pas, Bordi i Drejtorëve pasi hedhë në diskutim propozimin për shkarkim, me shumicë votash shkarkon paditësin nga pozita e Kryshefit Ekzekutiv.

Nga leximi i Konkursit publik për vend pune i shpallur nga Bordi i përkohshëm i Drejtorëve të të paditurës me datë 16.01.2021, Gjykata ka vërtetuar faktin se konkursi publik është shpallur në bazë të nenit 21.1 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike (Ligji nr. 03/L-087) dhe Rregullores për rregullimin e marrëdhënies së punës të të paditurës.

Po ashtu, përmes Rregullores nr. 01-478/21 të datës 18.02.2021 për rregullimin e marrëdhënies së punës për zyrtarët e lartë të Postës së Kosovës, Gjykata ka vërtetuar faktin se e paditura ka miratuar aktin e brendshëm për rregullimin e marrëdhënies së punës për zyrtarët e saj të lartë, kur përfshin ndër të tjera edhe themelimin, përkatësisht emërimin në pozita të larta drejtuese por edhe shkarkimin e tyre.

Nga pretendimet e palëve ndërgjyqëse dhe argumentimet e tyre gjatë seancave, vështruar edhe nga faktet dhe provat që dërguan deri tek gjendja e tillë faktike e vërtetuar, si çështje për argumentim ligjor paraqiten të jenë nëse Bordi i Drejtorëve ka pasur të drejtë t'i shkëpusë paditësit në atë mënyrë marrëdhënien e punës, si dhe çështja tjetër që përbënte pretendim të paditësit, se vendimi për largimin nga puna duhet të jetë i arsyetuar.

Neni 21 par. 1 i Ligjit nr. 03/L-87 për ndërmarrjet publike parashikon se *Zyrtarët e NP emërohen nga Bordi i Drejtorëve të NP. Zyrtarët shërbejnë për Bordin dhe Bordi mundet në çdo kohë dhe me shumicë votash ta ndërpresë kontratën e tyre me ose pa deklarimin e arsyes.[...] Ky Nen 21.1 mbizotëron mbi çdo dispozitë kontraktuese të themeluar me kontratë ose ligj, dhe do të pasqyrohet në Rregulloren e NP-së.* Gjykata vlerëson se paditësi me pozitën që ka mbajtur, i ka takuar zyrtarëve të lartë të të paditurës, prandaj procesi i emërimit dhe i shkarkimit i nënshtrohet dispozitave të Ligjit për ndërmarrjet publike.

Gjithashtu Gjykata gjen se neni 13 i Kontratës së punës të nënshkruar nga paditësi dhe e paditura, të protokolluar me nr. 01-1042/21 datë 16.04.2021, përcakton se të punësuarit i ndërpritet marrëdhënia e punës nga punëdhënësi konform nenit 9 të Rregullores nr. 01-478/21 të datës 18.02.2021 për rregullimin e marrëdhënies së punës për zyrtarët e lartë apo nëse [...]. Përderisa, Rregullorja nr. 01-478/21 të datës 18.02.2021 për rregullimin e marrëdhënies së punës për zyrtarët e lartë në Postën e Kosovës në nenin 9 përcakton se *“Punëdhënësi mund t’ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit me dhe pa deklarimin e arsyes në përputhje të plotë sipas nenit 21.1, nenit 23.1 dhe 23.2 të Ligjit nr. 03/L-87 për ndërmarrje publike. Kjo dispozitë mbizotëron mbi çdo dispozitë kontraktuese të themeluar me kontratë apo ligj, dhe do të jetë e inkorporuar në kontratat e punës së zyrtarëve të lartë”*. Në këtë drejtim, sipas vlerësimit të Gjykatës, përcaktimet kontraktuese nga kontrata e punës, përkatësisht dispozitat e aktit të brendshëm të punëdhënësit, këtu të paditurës, janë në linjë me përcaktimet e Ligjit për Ndërmarrjet Publike sa i përket shkarkimit të Kryeshefit Ekzekutiv, këtu paditësit.

Neni 18 par. 1 i Ligjit për ndërmarrjet publike parashikon se: *Bordi i Drejtorëve të NP-së do të ushtrojë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigoroze, në veçanti, të vepërimitarisë së zyrtarëve të NP-së.* Nga administrimi i procesverbalit mbi mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të të paditurës, datë 03.06.2021, është gjetur se ky organ pas diskutimeve të zhvilluara, kishte votuar me shumicë votash (me katër vota për) që të shkarkonte paditësin.

Në linjë të njëjtë me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, është edhe përcaktimi ligjor nga neni 108 par. 3 i Ligjit nr. 06/L -016 për Shoqëritë Tregtare, i cili përcakton se *Përveç nëse është*

përcaktuar ndryshe në Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, drejtori menaxhues shkarkohet me votën e aksionarëve ose Bordit të Drejtorëve. Aksionarët apo Bordi i Drejtorëve nuk kanë nevojë të deklarojnë arsyen për shkarkimin e tij, dhe personi i shkarkuar nuk ka të drejtë të kërkojë nga Aksionarët ose Bordi i Drejtorëve arsyen për shkarkimin e tij/saj.

Sipas vlerësimit të Gjykatës, qeverisjes korporative e ndërmarrjeve siç është e paditura, si dhe duke pasur parasysh se pozita që ka mbajtur paditësi kanë bërë pjesë në pozita të larta drejtuese, përmes Ligjit për ndërmarrjet publike, i janë dhënë autorizime organit të ndërmarrjes publike, gjegjësisht Bordit të Drejtorëve që të vendosë lidhur me shkarkimin e ndonjë zyrtari të lartë. Kjo nuk nënkupton se ndërmarrjet publike zyrtarët e lartë mundën që në mënyrë arbitrare t'iu shkëpusin kontratën e punës, mirëpo një gjë e tillë duhet domosdoshmërisht të bëhet duke cekur arsyet për një gjë të tillë. Së këndejmi, Gjykata vlerëson se e paditura përmes vendimit të saj i ka dhënë edhe arsyet lidhur me faktet vendimtare që kanë dërguar në nxjerrjen e vendimit për ndërprerjen e kontratës së punës.

Së këndejmi, Gjykata konstaton se rregullat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike, janë rregulla të veçanta të qeverisjes, që i japin kompetencë trupave qeverisëse brenda ndërmarrjes që të vendosin lidhur me emërimin dhe shkarkimin e zyrtarëve të lartë të saj. Në këtë kuptim, neni 21 par. 1 i Ligjit për Ndërmarrjet Publike i jep kompetencën Bordit të Drejtorëve që të vendosë për emërimin dhe shkarkimin e zyrtarëve të lartë, përfshirë këtu edhe Kryeshefin Ekzekutiv siç është rasti i paditësit, pa nevojën e njoftimit paraprak ose ndërmarrjen e masave paraprake. Andaj, Gjykata ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të Aktgjykimit duke refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar.

Gjykata gjithashtu ka vlerësuar pretendimet e paditësit se paditura përmes vendimit të saj nuk i ka dhënë arsyet lidhur me faktet vendimtare që kanë dërguar në nxjerrjen e vendimit për ndërprerjen e kontratës së punës, dhe ka ardhur në përfundim se një pretendim i tillë nuk është i bazuar, kjo pasi që sikurse u konstatua lartë dispozitat ligjore me të cilat i lejohet Bordit të bëjë shkarkimin e zyrtarëve të lartë (ku bënë pjesë edhe pozita të cilin e kishte mbajtur paditësi), nuk kërkohet pa tjetër të ketë arsyetim. Përkundër kësaj, në analizim të procesverbalit të mbledhjes së Bordit të Drejtorëve të së paditurës me nr. 09/2021 të datës 03.06.2021 para marrjes së vendimit për shkarkim të paditësit nga pozita e kryeshefit ekzekutiv, konstatohet se fillimisht janë elaboruar arsyet se pse duhet të merret vendimi për shkarkim të tij (arsyet e cekura sikurse në procesverbalin në fjalë), andaj duke i marrë për bazë këto vihet në përfundimin se Bordi i Drejtorëve të së paditurës ka arsyetuar vendimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit.

Gjykata po ashtu vë në dukje se duhet bërë dallim në mes procedurës disiplinore të një personi me status të të punësuarit që i nënshtrohen dispozitave të Ligjit të Punës, me atë të zyrtarëve të lartë të ndërmarrjeve publike, përkatësisht të pozitës së Kryeshefit Ekzekutiv që ka mbajtur paditësi, që i nënshtrohen dispozitave të një ligji special siç është Ligji për ndërmarrjet publike. Kësisoj, Gjykata e vlerëson të pabazuar pretendimin e paditësit se ndërprerja e kontratës së punës është bërë në kundërshtim të plotë me nenin 70 dhe 71 të Ligjit të Punës pa asnjë paralajmërim me shkrim së paku 60 ditë më herët duke qenë se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune me të paditurën mbi 10 vite, për faktin se ndaj paditësit nuk është aplikuar Ligji i Punës, e as nuk është

iniciuar procedurë disiplinore ndaj paditësit, por i njëjti është shkarkuar në pajtim me dispozitat e ligjit të veçantë për Ndërmarrjet Publike.

Sa i përket pretendimit të paditësit se vendimit të Bordit të Drejtorëve i mungon edhe këshilla juridike si element thelbësor kur vendoset për të drejtat e paditësit, Gjykata konstaton se lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit ka vendosur autoriteti më i lartë brenda institucionit, përkatësisht të paditurës, siç përcaktohet me Ligjin për Ndërmarrjet Publike. Në këtë drejtim, sipas vlerësimit të Gjykatës e drejta e paditësit për mbrojtje gjyqësore nuk është mohuar pasi që i njëjti bazuar në dispozitat ligjore ka iniciuar procedurë gjyqësore me të cilën ka kërkuar mbrojtje gjyqësore lidhur me pretendimet e tij.

Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor gjykata ka administruar edhe prova tjera si: Vendimi me nr. protokollit 01-1064/2021 datë 19.04.2021; Vërtetimi me nr. protokollit 03-1478/2021 datë 16.06.2021; Ekspertiza financiare e datës 23.04.2024 dhe plotësimi i saj i datës 31.05.2024; Rezultatet sipas kandidateve për Kosovë për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2019; dhe Certifikata nga evidenca penale e datës 22.10.2018, mirëpo të njëjtat nuk u arsyetuan posaçërisht, ngase nuk kishin rëndësi vendimtare që do të shpinin në vendosjen ndryshe si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase u vendos që padia të refuzohet.

Vendimin si në pikën II të dispozitivit për shpenzimet e procedurës Gjykata e mori duke u mbështetur në nenin 449 dhe 452 par. 1 të LPK-së, ashtu që ka detyruar paditësin që të paditurës t'ia paguajë shumën e tërësishme të shpenzimeve prej 1,409.60 euro dhe atë në emër të përgjigjes në padi shumën prej 208 euro, për katër seanca të mbajtura shumën prej 270.40 euro secila dhe në emër të plotësimi të ekspertizës shumën prej 120 euro.

Andaj, nga sa u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr. 4981/2021, datë 21.08.2024

Gjyqtari

Ermir Ahmetaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.